



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/01-2599/23  
Kaçanik, 31.01.2023

Në bazë nenit 13.4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 – për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna. Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 31 janar 2023, mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV**  
**PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA, PËR VITIN 2022**

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 060/01-2599/23 me tekstin e mëtejme, Raporti i Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2022, i hartuar nga Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.
2. Në Raportin e Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, është paraqitur aktiviteti i zhvilluar i këtij komiteti përmes mbledhjeve të rregullta dhe aktiviteti tjetër, me qëllim të arritjes së përmirësimit të gjendjes së personave me aftësi të kufizuara në komunën e Kaçanikut.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është, Raporti i Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, i përmbledhur në gjithsej 8 faqe.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara Kryetari i Komunës, dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli